

Survejimi dhe përndjekja gjatë periudhës komuniste në Shqipëri parë në analizën e pseudonimeve të përdorura nga ish-Sigurimi i Shtetit në vitet 1944 – 1991

Delina Binaj

BIO

Delina Binaj është mësimitdhënëse e gjuhës shqipe në Qendrën e Gjuhëve të Huaja në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Republikës Federale të Gjermanisë nga viti 2016 e deri më sot. Për më tepër, kërkuesja aktualisht, është angazhuar si përkthyes e gjuhës shqipe për fondacione politike dhe institute kërkimore të ndryshme në Republikën Federale të Gjermanisë.

Ka eksperiencë të ndryshme pune si koordinatore e degës së gjuhës shqipe në Institutin e Translatologjisë Teorike dhe të Aplikuar, Universiteti i Gracit.

Më 18/06/2024, ka përfunduar studimet e doktoraturës pranë Universitetit të Humboldt në fushën e gjuhësisë dhe studimeve gjinore, tema e doktoraturës: “Manifestime gjuhësore të konceptualizimeve gjinore në gjuhën shqipe” (Berlin).

ABSTRAKT

Miratimi nga Parlamenti i Shqipërisë në vitin 2022 të ndryshimeve në ligjin "Për të drejtën e informimit për dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit", që parashikon hapjen e të gjitha dosjeve të ish-Sigurimit të Shtetit dhe deklasifikimin e të gjithë dokumentave nga 29 Nëntori 1944 deri në 2 korrik 1991, shënon një ndryshim thelbësor në mënyrën e trajtimit në publik në Shqipëri të rishikimit të së kaluarës diktatoriale komuniste. Tashmë vëmendja në diskursin mediatik zhvendoset prej pseudonimeve të cituara shpesh e që janë përdorur kryesisht në politikë, për t'iu referuar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë personazheve politike, që supozohet se në të kaluarën e tyre kanë bashkëpunuar me ish-Sigurimin e Shtetit, te vetë fenomeni i spiunimit dheurvejimit të shoqërisë shqiptare nga një shtresë më e gjerë informatorësh dhe informatorësh.

Studimi i paraqitur synon të ofrojë një analizë me karakter ndërdisiplinor, duke kombinuar zbatimin e qasjeve nga disiplina e onomastikës, sociolinguistikës dhe antropologjisë kulturore, për të mundësuar një inventarizim të pseudonimeve të përdorura nëurvejimin dhe spiunimin e personave të përndjekur nga ish-Sigurimi i Shtetit në vitet 1944 - 1991 në Shqipëri. Në kumtesë do të prezantohen gjetjet e deritanishme të studimit të përfutuara nga dosjet e hapura dhe të deklasifikuara deri më sot. Ato zbulojnë qëndrimet dhe mënyrat e sjelljes, mentalitetet si edhe proceset e institucionalizuara nëurvejimin e personave të përndjekur.

Studimi synon të japë një kontribut nga një disiplinë pothuajse e pakonsideruar deri tani në trajtimin e së kaluarës, siç është gjuhësia, për analizën dhe vlerësimin e kulturës së përditshme tëurvejimit dhe përndjekjes gjatë periudhës komuniste në Shqipëri.